



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 38

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Prishtinë, më 14 shtator 2016, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Hatim Baxhaku, Fikrim Damka, Fadil Beka, Besa Baftiu, Time Kadrijaj, Shukrije Bytyçi dhe Adem Hoxha.

Mungoi: Mirjeta Kalludra.

Pjesëmarrës të tjerë: Zylfije Hundozi, kryetare e Odës së Mjekëve, Zehadin Gashi, kryetar i Odës së Farmacistëve, Kujtim Shala, kryetar i Odës së Stomatologëve, Naser Rrustemaj, kryetar i Odës së Infermierëve si dhe Dafinë Ibrahimli - Kryetare e Odës së Fizioterapeutëve.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

RENDI DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më: 13.07.2016, 21.07.2016 dhe 29.07.2016;
3. Takim me kryetarët e odave të profesionistëve shëndetësorë;
4. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor;
5. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më: 13.07.2016, 21.07.2016 dhe 29.07.2016

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më: 13.07.2016, 21.07.2016 dhe 29.07.2016, pa vërejtje.

3. Takim me kryetarët e Odave të profesionistëve shëndetësor

Kryetarja: Fillimisht me lejoni t'i përshëndes kryetarët e odave të profesionistëve shëndetësorë të cilët i kemi të pranishëm në mbledhjen e Komisionit me kërkesën e tyre, të cilët kanë kërkuar që të realizojnë një takim me Komisionin për të diskutuar lidhur me mos implementimin e Ligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë apo mos funksionalizimin e odave të profesionistëve shëndetësorë. Sa për njoftim, lidhur me mos zbatimin dhe funksionalizimin e odave të profesionistëve shëndetësorë, ne, si deputetë apo Komision, disa herë i kemi bërë pyetje dhe kemi diskutuar me ministrin Rrahmani dhe kemi kërkuar nga ai sa më parë funksionalizimin e odave të profesionistëve shëndetësorë. Fillimisht po i dëgjojmë shqetësimet e kryetareve të odave të profesionistëve shëndetësorë. Urdhëroni znj. Hundozi !

Zylfije Hundozi, kryetare e Odës së Mjekëve: Faleminderit e nderuara kryetare e Komisionit! Të nderuar deputetë. Ne ju falënderojmë që keni shprehur gatishmërinë për të na dëgjuar shqetësimet tona lidhur me funksionalizimin e odave dhe zgjidhjen e problemeve. Ju jeni në dijeni se Ligji për odat e profesionistëve shëndetësorë është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2013 dhe nga ajo kohë deri me ditën e sotme ky ligj nuk është implementuar përveç pjesërisht ku janë zgjedhur organet e odës; Kuvendi, komisionet edhe organet e tjera. Me këtë ligj janë përcaktuar veprimet të cilat duhet t'i ndërmerr Ministria e Shëndetësisë – MSH dhe gjithë ashtu janë përcaktuar afatet kohore për funksionalizimin e odave, gjegjësisht është përcaktuar, pra 4 (katër) muaj pasi që të kryhet përzgjedhja e të gjitha organeve të bëhet statuti dhe 6 (gjashtë) muaj pas aprovimit të statutit të barten të gjitha kompetencat publike dhe jo publike të odat dhe odat të bëjnë funksionalizimin e saj. Pra, ministria fillimisht është dashtë t'i kryej punët fillestare dhe të krijojë infrastrukturën për punën e odave në 4 (katër) muajt e parë. Pra sigurimin e selisë për odat. Selia është gjetur tash kohën e fundit para një muaji. Zyrën administrative dhe sekretarin i cili do ta udhëheq oden, buxheti i cili në tri vitet e para ka qenë i alokuar në MSH, mirëpo kuptohet me marrëveshje me u gjendur modalitetet, buxheti me u shfrytëzuar për punën e odave edhe t'i bartë kompetencat të parapara me ligj që janë edukimi i vazhdueshëm i profesionistëve shëndetësorë, çështjet etike, licencimi, rilicencimi dhe specializimet. Të gjithë këto deri me sot nuk kanë ndodhur. Me formimin e odës anëtarët e saj kanë filluar të punojnë vetë duke pasur një entuziazëm të madh dhe duke menduar se ndërkohë MSH do të caktojë zyrën administrative e cila që tri vite nuk është caktuar. Të gjitha aktivitetet deri me tani vullnetarisht pa pagës i kemi kryer ne, vetë, si kryetare e odes së mjekëve. Ne, si odë e mjekëve, kemi kontaktuar edhe odat e mjekëve të shteteve të tjera. Oda gjermane e cila

ka qenë sponzorizuese e ligjit dhe të odave dhe nga ta kemi kërkuar ndihme materiale të paktën për selinë e odave. Mirëpo ata duke ditur se ekziston një buxhet për oda në kuadër të MSH, nuk kanë shprehur dëshirë materialisht të na ndihmojnë, kurse përkrahje morale kanë dërguar letër ministrit të MSH, kryeministrit po ashtu kryetari i krejt Mjekëve të Botës, z. Otmar Killojberg, i ka dërguar letër Kryeministrit dhe ministrit të MSH, ku ka kërkuar nga ta funksionalizimin e odës. Ne jemi akuzuar shumë që s'kemi punuar, mirëpo oda e mjekëve në ndërkohë i ka mbajtur shtatë kuvende, i kemi bërë mbi 50 kërkesa MSH për funksionalizim të odës apo infrastrukturën për odë i kemi zgjedhur të gjitha organet e saj dhe i ka miratuar dokumentet. Ne, si odë, nuk kemi pasur mbështetje në aspektin ligjor për përgatitjen e dokumenteve ligjore krejt në formë private duke kontaktuar avokat, prokuror ku i kemi pyetur dhe kemi kërkuar që të na ofrojnë ndihmë në aspektin ligjor për të mos gabuar në punën tonë në hartimin e dokumenteve. Oda gjermane na ka ofruar mbështetje duke i kontaktuar përmes telefonit kur kemi pasur nevojë për çështje juridike. Ne i kemi miratuar të gjitha dokumentet statutin, kodin etik, rregulloret e nevojshme programet çdo vit i kemi dërguar, raportet për punën vjetore për punën e odave, prapëseprapë kemi tentuar në të gjitha mënyrat që me gjetur një gjuhë të përbashkët me ministrinë që mi funksionalizuarat odat pasi janë krijuar. Përgjigjeje nga ana e ministrisë për kërkesat tona kurrë s'kemi pasur. Një përgjigjeje ka qenë kur është nxjerrë vendimi nga ministri i MSH për neve kryetarëve të komisioneve për rroga, mirëpo kurrë nuk është realizuar. Është nxjerrë që tri vjet dhe nuk është realizuar. Ministrit të tashëm ne, si kryetarë të odave, i kemi bërë kërkesë disa herë për takime të përbashkëta për t'i kërkuar nga ai funksionalizimin e odave na ka injoruar. Kanë realizuar disa Workshope në Istog, Durrës, Prizren ku e ka marrë gjysmën e ministrisë me vete dhe ka nxjerrë vendim nga një përfaqësues i odave dhe si ka zbatuar asnjëherë. Kohëve të fundit kemi pasur presion si odë e mjekëve nga profesionistët shëndetësorë për shkaqet e licencimit dhe ri-licencimit ka filluar një proces i ngutshëm është dërguar një dokument në institucionet shëndetësore, ku kërkohej plan- programet deri në dhjetor të këtij viti t'i dërgohen MSH, s'kanë kaluar dy jave vjen një dokument tjetër i cili kërkon me filluar licencimi dhe ri-licencimi dhe kërkohej prej drejtorëve që me i grumbulluar krejt dokumentet dhe me i dërguar në MSh. Këshilli drejtues i Odës së mjekëve ka reaguar me shkrim dhe kemi thënë se nuk ka licencim kolektiv dhe i kemi njoftuar se bien ndesh me ligjin. Pra, pa i parapri një proces i mirëfilltë i edukimit të vazhdueshëm profesional licencimi shkel e shko kujt i duhet. Mjekësia ka nevojë për njerëz kompetentë dhe konkurrentë me kolegët tanë në tregun evropian, e sidomos në Ballkan. Pas shumë negociatave është premtuar se ri-licencimi do të bëhet, mirëpo ju si oda hapeni xhirollogaritë, tash se fundi na kanë thënë sa ajo nuk është e mundur sipas ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit. Ne përsëri kërkuam që të takohemi me ministrin dhe të kërkojmë sqarime pse tash nuk munden të bartin mjetet, nuk na ka pranuar në takim. Mandej kërkuam te Komisioni që të vijmë dhe t'i shprehim shqetësimin tonë dhe të kërkojmë nga ju mbështetje. Në këtë rast në emër të Odes së Mjekëve kërkojmë nga ju që të kërkonin nga Ministria e Shëndetësisë zbatimin e ligjit. Ne, si odë, na takon kompetenca e licencimit dhe ri-licencimit i takon odës dhe nëse nuk ndodh tash ajo xhirollogari do të jete e zbrazur dhe përsëri nuk do të mundemi të funksionojmë edhe në rast se barten të gjitha kompetencat pa buxhet nuk do të mundemi të ushtrojmë mandatin. Ne me ligj e kemi obligim që të jemi transparent në punën tonë. Unë një deklaratë që e kam dhënë për media, lidhur me mos funksionalizimin e odës së mjekëve. Ministria në web- faqen e saj ka bërë një shkrim ku përmes saj më ka kërcënuar dhe fyer personalitetin tim. Pikërisht për këtë shkrim kam pasur edhe pyetje nga gazetarët se a do të ndërmerri veprime kundër

këtij shkrimi i cili është publikuar në web- faqe të Ministrisë së Shëndetësisë. Unë ju kamë thënë se janë mekanizmat ligjor që duhet të veprojnë. Ju faleminderit!

Kryetarja bëri pyetje: Para disa javësh ministri i Shëndetësisë ka mbajtur një takim me udhëheqësit e institucioneve shëndetësore. A ju ka ftuar juve në këtë takim ?

Zylfije Hundozi, kryetare e Odës së Mjekëve: Jo nuk jemi ftuar në këtë takim. Unë plotësisht jam e injoruar prej anës së tij. Ne kemi kërkuar disa herë takim asnjëherë nuk na ka pritur. Tri herë jemi takuar së bashku në Gjermani, pra është dashtë Oda e Gjermanisë me ndërmjetësuar për me u takua dhe me biseduar me të.

Kryetarja: Po hapësirat apo zyrat e punës janë ndarë?

Zylfije Hundozi, kryetare e Odës së Mjekëve, po tash janë ndarë, na janë dhënë në shfrytëzim disa kontejnerë ku kanë qenë zyrat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Aty nuk ka as kushte elementare për punë. Nëse nuk kemi zyrë administrative, apo zyrtarë që do të punojnë kush do të qëndroj aty? Të gjitha takimet i kemi realizuar në Klinikën e Neurologjisë, në zyrën time dhe në sallën e studenteve të gjitha dokumentet i kemi përgatitur aty. Ne edhe për seli s' kemi bërë shumë problem. Tash në ato zyrë duhet me qenë sekretari, pra zyrë administrative që duhet t'i kryej punët teknike. Ju faleminderit !

Kryetarja: Po vazhdojmë t'i dëgjojmë me radhë kryetarët e odave të profesionisteve shëndetësorë mandej vazhdojmë më pyetje. Urdhëroni z. Shala.

Kujtim Shala, kryetar i Odës së Stomatologëve: Faleminderit e nderuara kryetare! Të nderuar deputetë. Ju faleminderit që na keni pranuar për t'u takuar me ju dhe për t' ju informuar për problemet që rrjedhin nga mos implementimi i ligjit të odave të profesionisteve shëndetësorë. Jeni përgjigjur shumë shpejt rreth kërkesës sonë për takim me Komisionin, kurse nga Ministria e Shëndetësisë kemi kërkuar disa herë për t'u takuar fatkeqësisht jemi injoruar në vazhdimësi, sa për njoftim ne jemi në pritje të përgjigjes nga ana e kryeministrit për realizim të një takimi, ku do të njoftojmë edhe atë për problemet dhe do të kërkojmë që sa më shpejt të funksionalizohen odat e profesionisteve shëndetësorë. Ne do të vazhdojmë t'i kërkojmë të drejtat tona edhe nëpër gjykata. Formimi i odave të profesionisteve shëndetësorë ka qenë e paraparë në kuadër të reformimit të sistemit shëndetësor i cili për momentin është jo efikas dhe jo funksional edhe nga pak i kriminalizuar fatkeqësisht. Odat janë treguar të suksesshme në çdo sistem që është funksional janë treguar se janë njeri prej mekanizmave i cili mundëson funksionimin e mirë të sistemit shëndetësor. Ne jemi në një situatë ku ligji për shëndetësi dhe ligji për odat e profesionisteve shëndetësor nuk po implementohen për dy arsyeje, njëra që s'po dinë edhe dy që s'po donë me i implementuar. Plotësisht e përkrahu kryetaren e odës së mjekëve se është problem madhor se profesioni mjekësor është një profesion i cili është jashtëzakonisht i ndjeshëm dhe besoj se ka qenë një nivel jo korrekt i komunikimit dhe i sulmeve që është bërë ndaj odes së mjekëve. Ka shumë probleme në mungesë të komunikimit në mungesë të zbatimit të ligjit dhe me kompetencë të plotë ju themi se ka subjektivitet në këtë punë. Kjo çështje mundet të tejkalohet në bazë të komunikimit edhe vullnetit për të zbatuar ligjin dhe funksionalizuar dhe ndarë buxhet për funksionim të odave. Ju faleminderit!

Kryetarja: Ju faleminderit ! Urdhëroni z. Gashi.

Zehadin Gashi, kryetar i Odës së Farmacistëve: Ju përshëndes dhe njëherë ju falënderojmë për mundësinë që na keni dhënë për të ju informuar për aktivitetet dhe problemet e odave. Unë nuk do të kthehem në retrospektiva apo t'i përsërisë ato që i thanë edhe koleget e mi. Mirëpo unë do të ndalem në shqyrtimin e mundësive që në bashkërisht si oda, ju si Kuvend dhe Qeveria, respektivisht Ministria e Shëndetësisë të shqyrtojnë mundësinë që sa më parë të funksionalizime odat. Mendoj se janë një ndër institucionet më të rëndësishme, për pos që bëjnë monitorimin e gjithë punës në sektorin shëndetësor janë edhe zëdhënës e gjithë punëtorëve shëndetësorë. Ligji e përcakton qartë se, më 31 maj 2016, odat i marrin kompetencat e plota dhe përgjegjësitë nga ministria e Shëndetësisë, kuptohet në mirëkuptim më të gjitha odat se kompetencat do të kalojnë shkallë-shkallë, varësisht prej kushteve dhe mundësive që ne i kemi krijuar për me u funksionalizuar si organe të pavarura. Në këtë aspekt, në kuadër të odës së farmacistëve të Kosovës, ne, si odë edhe unë personalisht jemi munduar që t'i përmbahemi ligjit si në formimin e organeve të odës dhe ushtrimin e detyrës si kryetar ku kërkon kriteret në mbajtjen e detyrës. Nuk është lehtë që dy vite e gjysmë të punohet pa kurrfarë kompensimi, aq më tepër me shpenzime tona për të krijuar një institucion i cili konsideroj që është një ndër institucionet më të rëndësishme në sistemin shëndetësor. Ne kërkojmë nga ju që të na ndihmoni në funksionalizim të odave. Ajo që konsiderojmë që është e rëndësishme së veçantë për momentin është zgjidhja e problemit të buxhetit për odat. Ne, më 31 maj 2016, në bazë të ligjit jemi institucione të pavarura në aspektin buxhetor nuk varemi nga Ministria e Shëndetësisë dhe në këtë rast MSH e ka tërhequr gjithë buxhetin që ka qenë i dedikuar për këtë vit dhe ne jemi me buxhet zero (0). Problem tjetër është siç u përmend na është kërkuar që të hapet një xhirollogari që ne me anë të tarifave për licencim dhe ri-licencim edhe ky problem ka ngecur dhe ne për momentin s'kemi buxhet dhe se s'mundemi të punojmë e as t'i ushtrojmë kompetencat. Aspekti i edukimit të vazhdueshëm profesional dhe procesi i licencimit dhe ri-licencimit ne duhet të jemi të vetëdijshëm se edukimi i vazhdueshëm profesional dhe ngritja profesionale e profesionisteve shëndetësorë konsideroj se është në nivelin më të pa kënaqur që mundet me qenë. Përpos që i kemi përmbushur obligimet ligjore dhe kërkesave të MSH kemi përgatitur edhe programin për procesin e ri-licencimit i cili ka pasur të fillojë nga shtatori deri në dhjetor me program të përshpejtuar, mirëpo pa mjete s'kemi mundur t'ia fillojmë. Kërkojmë nga ju që të na mbështetni në gjetjen e një mundësie në financimin e odave për kryerjen dhe ushtrimin e kompetencave. Po ashtu është planifikuar nga një asistent për odat dhe sot na njoftuan se është anuluar konkursi për përzgjedhjen tyre prej 300 kandidatëve sa kanë aplikuar tash diku se paku edhe dy muaj i duhen për zhvillimin e procedurave të reja. Ndoshta dikujt i pengon funksionimi i odave, ne kemi marrë pjesë në disa komisione për përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore. Ne i përgatisim në Komision dhe në Kuvend shpeshherë miratohet një ligj krejt tjetër në atë që është punuar nga komisionet profesionale. Për fund kërkojmë nga ju që të gjendet një mundësi që odat sa më parë të funksionalizohen. Ju faleminderit!

Kryetarja: Ju faleminderit! Urdhëroni z. Rrustemaj.

Naser Rrustemaj, kryetar i Odës së Infermierëve: E nderuara znj. kryetare e Komisionit, të nderuar deputetë. Ju falënderojmë në emër të odës së infermiereve dhe mamive për këtë takim dhe

shpresojmë se nga ky takim do të dalim me konkluzionet lidhur me funksionalizimin e odave të profesionisteve shëndetësorë. Unë nuk do të ndalem apo përsërisë ato vështirësitë që jemi përballur deri me tani, mirëpo do t'ju njoftojë lidhur me vendimet të cilat janë marrë nga ministri i Shëndetësisë dhe nuk janë implementuar, pra vendimi i datës: 29.03.2016, ku është paraparë hapja e nën kodeve dhe nuk janë hapur deri sot. Më 30.06.2016, ministri ka marrë një vendimi ku do të bartën kompetencat për edukimin e vazhdueshëm dhe kodi etik. Si mundet të barten kompetenca për edukim të vazhdueshëm pa mjete buxhetore. Siç dihet odat parashihet të vetë financohen nga anëtarësia, licencimi dhe ri-licencimi, mirëpo edhe kjo gjë s'po lejohet. Ne gjithë po potencojmë se problemi qëndron të kostoja financiare. Mirëpo ligji i odave të profesionisteve shëndetësorë nuk kërkon kosto financiare pasi që parashihen të vetëfinancohen nga anëtarësia dhe taksat për licencim dhe ri-licencim. Ne kërkojmë nga ju që të kërkonin nga ministria që kompetencat e odave të bartën sa më parë tek odat dhe të zbatohet ligji i odave. Po ashtu edhe për administratë e parasheh ligji që të kalojnë në kuadër të odave. Ne kërkojmë që se paku një numër i nevojshëm të stafit për momentin. Ne do të kërkojmë vetëm të drejtat që na takojnë në bazë të ligjit. Ju faleminderit!

Dafinë Ibrahim, kryetare e Odës së Fizioterapeutëve: Përsëritje për të gjithë të pranishmit. Ju faleminderit për pritjen në këtë takim. Diskutimet e parafolësve janë probleme të gjitha odave dhe s'do të zgjatet apo s'do përsërisë problemi është stagnimi, pra na kanë bllokuar. Kompetencat na kanë dhanë, kurse ne s'kemi buxhet. Pra, kompetencat e licencimit dhe ri-licencimit na janë bartur, kurse buxheti jo, kurse të hyrat që gjëndërohen prej licencimit është paraparë që të shkojnë në kode të Ministrisë së Shëndetësisë që nuk thuhet askund se ato mjete kanë me u bartur në xhirollogaritë e odave. Ne nuk jemi të sigurt që a të fillojmë me licencim dhe ri-licencim edhe pse ka filluar se si ka filluar dhe ne nuk mund të ju themi profesionisteve shëndetësorë se ai buxhet në fund do të na bartet në xhirollogarinë e odes. Ne, si odë, kemi punuar një vit e gjysmë pa para, kishim punuar edhe tre katër muaj që të grumbullohet ai buxhet dhe të vazhdojë procesi si duhet siç parashihet me ligj. Problemi i sekretarisë i administratës. Mirëpo prapëseprapë buxheti që do të mbledhet gjatë licencimit dhe ri-licencimit të na kishin premtuar se do të na bartet. Ne do t'i kishim kaluar këto probleme, pra na duhet një bashkëpunim në zbatim të ligjit. Ju faleminderit shumë për përkrahjen tuaj!

Kryetarja: ju faleminderit të gjithëve! Kjo ka qenë edhe breng e jona si Komision. Ne kur kemi vendosur monitorimin e Ligjit të shëndetësisë kemi menduar edhe të kjo pjesë e organizimit dhe funksionimit të odave të profesionisteve shëndetësorë. Pra, mos funksionimi i odave që është pjesë themelore e reformës në shëndetësi. Takimet që kemi pasur me ministrin e Shëndetësisë kemi shprehur shqetësimet tona lidhur me mos funksionalizimin e odave. Atëherë po u a kaloj fjalën te deputetët e Komisionit nëse ka dikush nga ta ndonjë pyetje apo koment. Urdhëroni znj. Baftiu.

Besa Baftiu: Faleminderit kryetare, përsëritje për të pranishmit kryetar të odave. Pra, shumë mirë na kujtohet para tri vjetëve kur është miratuar në Kuvend Ligji për odat e profesionisteve shëndetësorë, ka qenë një bujë e madhe që besoj ka qenë për të mirë dhe ju kemi përgëzuar të gjithë. Tash po bahen tri vjet dhe ky ligj nuk po implemnetohet me ardhjen e ministrit të ri, z. Rrahmani. Ai vetëm e ka konstatuar gjendjen në shëndetësi, gjendja është e keqe. Mirëpo sa i përket asaj që të punoj në këtë drejtim dhe t'i zgjidhe problemet në sistemin shëndetësor e një nderë to funksionalizimin e odave. Pra, nuk kemi ndonjë lëvizje për të mirë vetëm në të kundërtën është

përkeqësuar situata. Me sa kemi vërejtur nuk keni qenë shumë të pranishëm në media, pra nuk e keni bërë publike këtë punën e juaj që e keni bërë apo mos përkrahjen apo përgjigjeje në kërkesat të juaja nga ana e ministrit. Unë i kam vizituar ambientet ku janë ndarë si hapësira për punë, apo seli të odave, pra ishin disa kontejnerë aty me të vërtetë nuk kishte kushte për punë. Ju, si kryetar të odave, është dashtë të thirrni një debat me qytetarë me ekspertë të fushës së shëndetësisë, komisionin, qeverinë, ministrin e Shëndetësisë të diskutohen problemet aty bashkërisht. Kryetari i odës së infermiereve potencoi se u janë bartur kompetencat e edukimit të vazhdueshëm, si dhe të kodit etik, mirëpo buxhet nuk ju është bartur. Një pyetje: a konsultoheni ju si kryetar të odave dhe të dakordoheni që të mos i pranoni kompetencat gjysmake, mirëpo t'i pranoni kompetencat ashtu siç i parasheh ligji. Kurse odës së mjekëve nuk ju kanë bartur këto dy kompetenca më arsyen se nuk e kanë mbajtur mbledhjen e Kuvendit. Mirëpo edhe pse oda e ka mbajtur kuvendin me vonë kompetencat ende nuk ju janë bartur. Po ashtu ju potencuat se edhe pse i keni pranuar këto dy kompetenca nuk jeni duke ushtruar funksionin ashtu siç parashihet. Ligji ka paraparë që në tri vitet e para ministria t'i financojë pas kësaj ju të vetëfinancoheni. Një gjë e tillë s'ka ndodhur edhe fajtori është Ministria e Shëndetësisë. Pra, ministri i Shëndetësisë i cili s'ka komunikim të mirëfilltë me ju. Pra, ka mungesë të komunikimit mes jush, e si mund të zgjidhen problemet. Ju faleminderit !

Zylfije Hundozi, kryetare e Odës së Mjekëve: Ju faleminderit për pyetjen deputete. Sa i përket qasjes së mediave. Unë kam komunikuar, mirëpo më ka kushtuar shumë shtrenjtë. Ministria e Shëndetësisë e ka shkruar një letër edhe ka kërkuar nga kuvendi i odes që të me shtinë më dhanë dorëheqje nga detyra e kryetares. Mirëpo kam pasur një përkrahje maksimale nga anëtarët e kuvendit dhe krejt mjekëve për arsye se neve ligji na obligon sa i përket transparencës apo komunikimit me media. Ku thotë se oda e mjekëve duhet me qenë transparente dhe me e njoftuar opinionin publik për punën e tyre. Ne kemi pasur shkrime, kërcënime e fyerje të ndryshme në raport me atë se kemi komunikuar me media edhe kemi shprehur shqetësimet edhe problemet tona me mos funksionalizimin e odave.

Time Kadrijaj: Më vjen mirë që po e adresojmë një shqetësim të qëlluar. Është mirë që të gjitha kërkesat e Odave t'i artikulonin në një shkresë dhe të ja drejtoni Komisionit tonë. Komisioni ka kompetenca të mjaftueshme t'i drejtohet Ministrit të Shëndetësisë dhe t'i adresojë kërkesat tuaja. Kërkoj që në një mbledhje të radhës të ftohet ministri i Shëndetësisë me temën për mos funksionalizimin e odave të profesionistëve shëndetësorë. Kam qenë pjesë e Komisionit në amendamentimin e Ligjit të Odave të profesionistëve shëndetësorë dhe kam qenë entuziaste se këto ligje të reformës shëndetësore do të ndihmojnë shëndetësinë, por po shohim se ka ngecje në zbatim të ligjeve. Gjatë amendamentimit të Projektligjit të Odave jemi kujdesur të mos ketë përzierje të kompetencave në mes odave dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe ato kompetenca që kalojnë të odat të jen sa më të zbatueshme.

Nuk ka arsyetim për këtë neglizhencë sepse ligji e parasheh afatin e zbatimit, prandaj Ministria e Shëndetësisë është dashur të zbatojë ligjin sipas afatit të paraparë. Më vjen keq për doktoreshën Zylfije Hundozi që ka qenë e kërcënuar në këtë formë, sepse nuk është as etike dhe as humane, dhe ju nuk jeni emëruar nga ministri i Shëndetësisë, por keni kaluar në procese zgjedhore, dhe jeni të zgjedhur me votën e profesionistëve shëndetësorë, dhe është e drejta e juaj t'i përfaqësoni në mënyrë dinjitoze profesionistët shëndetësor. Kërkoj edhe një herë t'i artikulonin kërkesat tuaja që janë të drejta por edhe shqetësuese pse nuk janë zbatuar.

Kryetarja: Ka qenë shqetësim edhe i këtij Komisioni mos funksionalizimi i Odave, dhe këtë ja kemi shprehur edhe ministrit të Shëndetësisë. Do të vendosim si Komision për ftesën ministrit, që t'ia paraqesim edhe një herë kërkesat tuaja.

Fadil Beka: Përshëndes pjesëmarrjen e kryetarëve të odave të profesionistëve shëndetësorë. Konsideroj që odat e mjekëve janë shtylla kryesore e shëndetësisë. Desha t'i adresoj disa pyetje, çfarë mendoni pse nuk janë bartur kompetencat nga Ministria e Shëndetësisë te Odat, pastaj sa i përket lokacionit mendoj se ka pasur mundësi të bëhet zgjidhje më e mirë. Gjithashtu stafi aktual i Ministrisë së Shëndetësisë i cili merret me licencimet, është dashur të bartet te odat, por se di përse nuk është bartur. Sa i përket buxhetit, tani është duke u përgatitur buxheti për vitin 2017, a ju ka konsultuar ndokush ?

Kujtim Shala: Ne kemi qenë të koordinuar tërë kohën, por nuk kemi dashtë që këtë çështje ta nxjerrim jashtë binarëve institucional dhe ky problem të jetë në agjendën e dikujt, sepse është problem që na takon të gjithëve.

Rruga është që ne t'i drejtohem Ministrisë së Shëndetësisë, por komunikimi ka munguar dhe se kanë qenë dy faktorë, nuk din ta zbatojnë ligjin, dhe nuk duan ta zbatojnë. Ligji është jashtëzakonisht i qartë. Edhe çështja e transferimit të personelit nuk mundën ta realizojnë, thjesht thanë nuk mund ta transferojmë personelin. Na than se ju duhet ta përzgjidhni personelin, por në fund i përzgjedhi ministria pa asnjë kriter. Edhe lokacioni i përzgjedhur është turp të ndahet për odat. Por ne prapë do të vazhdojmë me rrugë institucionale.

Shukrije Bytyçi: Vërtet është shqetësuese mosfunksionimi i odave dhe moszbatimi i Ligjit. E dimë se Odat janë promotor i zhvillimit të shëndetësisë. Nuk po mund ta arsyetoj neglizhencën e juaj dhe mos ngritja e zërit. Është dashtë të jeni më të zëshëm. Pajtohem edhe me propozimin ta ftojme ministrin dhe të diskutojmë për funksionalizimin e Odave të profesionistëve shëndetësorë. Ne po ballafaqohemi çdo ditë me probleme në shëndetësinë.

Ju jeni zgjedhur nga kolegët e juaj për t'i përfaqësuar dhe nuk duhet të ndikoheni nga akuzat dhe kërcënimet. Më vjen keq për kërcënimet që ka marrë zonja Zylfije Hundozi, por fatkeqësisht qeveritarët tanë me kërcënime po mundohen të ju bëjnë të heshtur, por edhe ju sikurse ne jeni të zgjedhur t'i përfaqësoni interesat e profesionistëve shëndetësorë, prandaj mos heshtni. Ne do të mbajmë sa më shpejt një takim me ministrin dhe ta diskutojmë mos funksionalizimin e odave.

Hatim Baxhaku: Përshëndes kryetarët e odave. Ne jemi këtu për të gjetur një zgjidhje sepse të gjithë e dimë rëndësinë e odave të profesionistëve shëndetësorë dhe e kemi mirëpritur funksionalizimin e odave. Ne e dimë se ka vonesa qoftë të arsyeshme, qoftë të pa arsyeshme në funksionalizimin e odave. Ka pas vonesa edhe në konstituimin e vet odave. Pra, duhet të jemi të sinqertë se edhe odat nuk kanë qenë të përgatitur t'i marrin kompetencat që ju takojnë me ligj. Nuk bën të akuzojmë që vetëm ministria nuk ka kryer punën, sepse as odat nuk kanë qenë plotësisht funksionale dhe nuk kanë qenë në gjendje t'i marrin kompetencat. Pra, bartja e kompetencave duhet të bëhet hap pas hapit. Nuk e arsyetoj këtë vonesë dyvjeçare por të gjithë duhet të marrin përgjegjësit që u takojnë. Kërkoj të na listoni kërkesat tuaj, cili është hapi i parë e cilët janë hapat tjerë që duhet ndërmarr që të funksionalizohen odat. Ju që jeni kryetar të odave a keni ndonjë funksion publik?

Besa Baftiu: Më duket pata një keqkuptim në diskutimin tim, sepse kryetari i odës së stomatologëve tha se ne nuk kërkojmë zgjidhje joinstitucionale. Nuk kërkoja që të ketë zgjidhje joinstitucionale, thash pse nuk keni organizuar debat publik me anëtarësinë, me profesionistë, me sindikalistë, me ekspertë vendorë dhe të jashtëm, dhe të sensibilizoni çështjen.

Kryetarja: Edhe me sindikalistët kemi diskutuar për mos funksionalizimin e odave. Gjithashtu edhe lista e profesioneve shëndetësorë në Kosovë është e mangët dhe nuk përfshin disa profesione që studentët e Kosovës po i kryejnë jashtë Kosovës. Kam marrë pjesë në disa kuvende zgjedhore të odave dhe e di që zgjedhja e juaj ka qenë demokratike. Prandaj duhet të punoni për anëtarësinë që ju ka zgjedhur sepse e di që pa funksionalizimin e odave reformë shëndetësore nuk ka. Komisioni është shumë i interesuar që të zbatohet Ligji i shëndetësisë dhe ligjet që burojnë nga ai ligj, si Ligji i odave të profesionistëve shëndetësorë.

Mungesa buxhetore kemi si për zbatim të këtij ligji, ashtu edhe për ligjet e tjera. Tani kemi amendamentuar Projektligjin e shërbimit emergjent, por edhe ai ligj ka pengesa buxhetore, dhe nuk kemi përgjigje pozitive.

Zehadin Gashi: Kërkesa ime themelore është funksionalizimi i odave dhe prej jush kërkojmë të na ndihmoni t'i funksionalizojmë odat. Dy çështje janë më të rëndësishme, së pari buxheti sepse me marrjen e buxhetit odat pavarësohen. E dyta, sa i përket çështjes së bërjes publike të problemeve, ne kemi qenë në themelim e sipër të odave dhe gjithë energjia ka qenë e fokusuar në krijim të organeve të odave. Tani që i kemi krijuar këto organe kemi bërë hapin e parë, dhe tani ju kem drejtuar institucionit kryesor si jeni ju.

Hapi i parë i funksionalizimit të odave është ndarja e buxhetit, por ministra po kërkon që të hyrat të mbledhen në nën kodin e ministrisë. Unë jam kundër mbledhjes së të hyrave në kuadër të nën kodit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Kërkoj nga ju që të diskutoni me ministrin apo kryeministrin që ta gjeni një mundësi që ne ta marrim buxhetin dhe të funksionalizohen odat.

Hatim Baxhaku: A munden odat të funksionojnë vetëm me vetëfinancim?

Zehadin Gashi: Sipas Ligjit për shëndetësi ministrisë i takojnë disa kompetenca, si mbikëqyrja e zbatimit të ligjit. Kompetencat që ne nuk jemi në gjendje t'i kryejmë dhe nuk do t'i marrim.

Kryetarja: Ne do t'i diskutojmë me ministrin e Shëndetësisë të gjitha problemet e mos funksionalizimit të odave. Ju falënderoj për pjesëmarrje dhe për informimin.

4. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor

Kryetarja: Draft- planin e punës së Komisionit për sesionin vjeshtor e keni marrë, nëse jeni dakord e analizoni dhe do ta diskutojmë dhe miratojmë në një mbledhje të radhës. Komentet për plotësimin e planit i dërgoni me shkrim.

Pas diskutimeve anëtarët e Komisionit u pajtuan që plani i punës për sesionin vjeshtor të miratohet në mbledhjen e radhës.

5. Të ndryshme

Kryetarja: Së pari do të vazhdojmë me monitorimin e Ligjit për shëndetësi, dhe do të vazhdojmë me vizitat në Shtërpçë dhe në Prizren. Gjithashtu të ftohet ministri i Shëndetësisë që të raportojë në Komision për funksionalizimin e Odave të profesionistëve shëndetësorë.

Fikrim Damka: Të kërkohet informata nga Ministria e Punës për çështjen e postës, pra të na njoftojnë me rezultatin e punës së Komisionit të përbashkët për kërkesën e Postës së Kosovës për shpërndarje të skemave sociale.

Kryetarja: T'ju njoftoj se ka filluar implimentimi i marrëveshjes së huas me Austrinë dhe sipas vendimit të Kuvendit ne do të bëjmë monitorimin e marrëveshjes. Prandaj të formojmë një grup punues i cili do të merret me monitorimin e marrëveshjes.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që monitorimi i implementimit të marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeveris së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës të bëhet nga anëtarët e Komisionit Fikrim Damka – kryesues, Fadil Beka – anëtar, Shukrie Bytyçi – anëtare dhe Hatim Baxhaku-anëtar.

Fikrim Damka: T'ju njoftoj se në Komisionin për Buxhet dhe Financa është diskutuar për Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent dhe ministri i Financave e kundërshton ashpër kalimin e ligjit dhe kërkon ose të kaloj drafti që ka ardhur nga ministria ose të tërhiqet ligji, se nuk do të ketë buxhet të zbatohet ligji sepse ka implikime buxhetore. Ne kemi marrë pëlqimin e kryeministrit të punojmë në ligj, e jo tani të tërhiqet.

Kryetarja: Ne do të caktojmë një takim me kryeministrin, me ministrin e Financave dhe me ministrin e Shëndetësisë dhe ta diskutojmë mundësinë e miratimit të ligjit. Gjithashtu kemi edhe disa tema tjera t'i trajtojmë si ndërmarrjet sociale për të cilën kemi marrë edhe një hulumtim të bërë nga KDI, pra të përgatitemi sa më mirë për këtë temë. Një çështje tjetër që dua ta ngritë është edhe mbajtja e një konference ndërkombëtare për autizëm, sepse është një temë e ndjeshme, por që nuk është e trajtuar në Kosovë, çështja e autizmit. Do ta organizojmë edhe një vizitë në Preshevë me qëllim që të njihem me çështjet shëndetësore në këtë Komunë, si dhe me çështjet e punësimit. Edhe një vërejtje për të dy ministrinë, si për atë të Shëndetësisë po ashtu edhe për atë të Punës se nuk po na ftojnë në tryeza të ndryshëm ku po diskutohen çështje me rëndësi, e ku edhe Komisioni do të duhej ta japë kontributin.

Ju falënderoj për pjesëmarrje në mbledhje dhe për kontributin tuaj.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA